



Pranuar / Dorezuar Primljeno/Prodato Received/Delivery	14. 03 2022	viti god year	2
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKILLYSHICK	1345/2022		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.69/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari -kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë si dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.69/2022 të datës 27.01.2022 e parashtruar nga ankuesit

perfaqësues i grupit, me adresë Kruga Komuna e Istogut, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 11.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.69/2022 e datës 27.01.2022, e parashtruar nga ankuesit dhe perfaqësues i grupit.

A r s y e t i m

Ankuesi sipas kontratës së punës për kohë të caktuar është i sistemuar në vendin e punës “Zyrtar Korrektues” në Qendrën Korrektuese në Dubravë, sipas kontratë pune për kohë të caktuar është i sistemuar në vendin e punës “Zyrtar Korrektues” në Qendrën Korrektuese të Dubravë,

sipas kontratës pune për kohë të caktuar është i sistemuar në vendin e punës “Zyrtar Korrektues” në Qendrën Korrektuese të Dubravë, sipas kontratës së punës për kohë të caktuar është i sistemuar në vendin e punës “Zyrtar Korrektues” në Qendrën Korrektuese në Dubravë,

sipas kontratës së punës për kohë të caktuar është i sistemuar në vendin e punës “Zyrtar Korrektues” në Qendrën Korrektuese në Dubravë, të cilët me datë 29.09.2021 kanë parashtruar kërkesë tek Udhëheqësi i Divizionit të Trajnimeve për “ndryshimin e kontratave të punës nga „Zyrtar korrektues” në „Instruktor” dhe të ndryshohet koeficienti nga 6 në koeficient 7”, mirëpo ankuesit nuk marrin përgjigje lidhur me kërkesën e tyre dhe me datë 24.11.2021 nëpërmjet Postës së Republikës së Kosovës parashtrajnë ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të cilën ankesë Këshilli e ka pranuar me datë 26.11.2021 me numër të protokollit 5685/2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me datë 10.01.2022 merr vendimin me të cilin detyrohet Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues, që të bëjë rishqyrtimin e kërkesës së datës 29.09.2021 të parashtruar nga ankuesit, pas marrjes së këtij vendimi Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm i u përgjigjet kërkesës së ankuesve të datës 29.09.2021.

Ankuesit të pa kënaqur me përgjigjen e datës 21.01.2022 me numër 0069 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm me datë 25.01.2022 nëpërmjet Postës së Kosovës parashtrorjnë ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të cilën ankesë Këshilli e ka pranuar me datë 27.01.2022 me numër të protokollit 369/2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesve e datës 27.01.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjia e datës 21.01.2022 me numër 0069; Ankesa e ankuesve e datës 26.11.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi i

dhe për E-mail i datave 20.10.2021, 05.11.2021, 12.10.2021; Kërkesa e datës 12.10.2021 e parashtruar tek Këshilltari Politik i Ministrisë së Drejtësisë; Kërkesa e datës 29.09.2021 e parashtruar tek Udhëheqësi i Divizionit ligjor i Shërbimit Korrektues të Kosovës; Kontratë pune për kohë të pacaktuar për Lista e nënshkrimeve e datës 22.11.2021 e Instrukturëve të Armatimit; Certifikata për e datës 06.07-24.07.2009; ID e punës për Certifikata e e datës 04-22.10.2004; Certifikata e e datës 06.7-24.07.2009; Certifikata e e datës 24.11.2004; ID e Certifikata e e datës 05.11.2004; Certifikata e e datës 21.03.2008; Certifikata e e datës 24.11.2004; Certifikata e Certifikata e datës 22.10.2004; Certifikata e e datës 24.11.2004; Certifikata e e datës 06.07-24.07.2009; ID e punës për Certifikata e e datës 26.01-27.02.2009; Certifikata e e datës 06.07-24.07.2009; Certifikata e maj 2006; Certifikata e e datës 08.03-12.03.2010; ID e punës e Ushtrime me Çursi themelor për dhe Kontrata e punës për kohë të pacaktuar e Kontrata e punës për kohë të pacaktuar e Kontrata e punës për kohë të pacaktuar e Kontrata e punës për kohë të pacaktuar e Kontrata e punës për kohë të pacaktuar e Kontrata e punës për kohë të pacaktuar e Kontrata e punës për kohë të pacaktuar e Rekomandim për përtërije të kontratës e datës 18.04.2018 për Përshkrimi i detyrave të punës si dhe përgjigjia në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjes e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesit dhe përfaqësues i grupit, është e **pa bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, nga provat e lëndës ka konstatuar se ankuesit ka nënshkruar kontratë për punë për kohë të caktuar me datë 22.06.2018 me koeficient gjashtë (6); ka nënshkruar kontratë për punë për kohë të caktuar me datë 22.06.2018 me koeficient gjashtë (6); ka nënshkruar kontratë për punë për kohë të caktuar me datë 18.06.2018 me koeficient gjashtë (6); ka nënshkruar kontratë për punë për kohë të caktuar me datë 22.06.2018 me koeficient gjashtë (6) dhe ka nënshkruar kontratë për punë për kohë të caktuar me datë 19.06.2018 me koeficient gjashtë (6).

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se neni 7 paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë i cili përcakton se: **“Udhëheqësit e institucioneve të administratës publike ia propozojnë gradat e pozitave në institucionin e tyre ministrisë përgjegjëse për administratë publike, në bazë të rekomandimeve të personit përgjegjës për burime njerëzore në institucionin e tyre, i cili është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe procedurave për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil”** dhe **“Grada për secilin pozicion të punës dhe ndryshimet, miratohen nga Qeveria, me**



propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financat”, rrjedhimisht Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ligjërisht ngritja e koeficienteve për nëpunësit civil, mund të bëhet vetëm nëpërmjet procedurave ligjore e që duhet të dëshmohet se institucioni ka planifikuar mjete buxhetore të miratuara nga ministria përgjegjëse për administratë publike respektivisht ministria përgjegjëse për financa, kështu përderisa nuk ka planifikim buxhetor apo nuk ka kërkesë nga institucioni ku nëpunësi civil është duke e ushtruar pozitën tek institucionet gjegjëse, atëherë përderisa nuk plotësohen kushtet e tilla ligjore nëpunësi civil paguhet me pagë siç është përcaktuar në aktin e emërimit/kontratën e punës me të cilin ka themeluar marrëdhënien e tij të punës, siç parashihet me Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, respektivisht neni 9 paragrafi 1 përcakton se: “Nëpunësit civil kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara në aktin e kontratës së punës” dhe neni 19 të Ligjet Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: “Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave”.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.69/2022

Valentina Kaçandolli-Bekteshi

Valentina Kaçandolli
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Malsore Gashi
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet;

- Përfaqësuesit të ankuesve
- Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

